



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 22 Korrik 2021

Nr: 429

V E N D I M

P Ë R

**KOMPENSIMIN FINANCIAR PASZGJEDHOR QË DO T'U SHPËRNDAHET
SUBJEKTEVE ZGJEDHORE PJESËMARRËSE NË ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E
SHQIPËRISË, TË DATËS 25 PRILL 2021**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “k” e “n”, dhe 2, 89 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe vendimit nr. 21 datë 13.07.2021, të Komisionit Rregullator, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021”,

V Ë R E J:

Neni 89, i ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikon kompensim financiar paszgjedhor për subjektet zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhje, të cilat nuk kanë përfituar fonde sipas vendimit nr.172, datë 23.03.2021 “Për përcaktimin e sasisë së fondit nga Buxheti i Shtetit që do t’u shpërndahet si paradhënie partive pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka detyrimin t’u kompensoj fonde nga Buxheti i Shtetit atyre subjekteve zgjedhore të cilat kanë marrë jo më pak se 1% të votave të vlefshme në shkallë vendi në zgjedhjet e datës 25 Prill 2021.

Partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore që kanë përfituar fonde paradhënie të akorduara nga buxheti i shtetit në zgjedhjet e datës 25 Prill 2021, janë si më poshtë:

1. Partia Socialiste e Shqipërisë - 55.826.750 (pesëdhjetë e pesë milion e tetëqind e njëzetë e gjashtë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë.
2. Partia Demokratike - 33.318.149 (tridhjetë e tre milion e treqind e tetëmbëdhjetë mijë e njëqind e dyzetë e nëntë) lekë.



3. Lëvizja Socialiste për Integrim - 18.975.182 (tetëmbëdhjetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e njëqind e tetëdhjetë e dy) lekë.
4. Bindja Demokratike - 1.485.550 (një milion e katërqind e tetëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë.
5. Partia Social Demokrate - 1.629.360 (një milion e gjashtëqind e njëzet e nëntë mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë.
6. Partia Republikane - 3.926.232 (tre milion e nëntëqind e njëzet e gjashtë mijë e dyqind e tridhjetë e dy) lekë.
7. Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar - 1.434.012 (një milion e katërqind e tridhjetë e katër mijë e dymbëdhjetë) lekë.
8. Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet - 5.552.885 (pesë milion e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë e tetëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë.
9. Partia Fryma e Re Demokratike - 2.188.832 (dy milion e njëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e tridhjetë e dy) lekë.
10. Partia Demokristiane e Shqipërisë - 1.479.742 (një milion e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e dyzetë e dy) lekë.

Partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e datës 25 Prill 2021, të cilat nuk kanë përfituar fonde paradhënie dhe kanë marrë mandat në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë janë si më poshtë:

1. Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë - 1 mandat
2. Partia Lëvizja e Legalitetit - 1 mandat
3. Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut - 1 mandat

Të treja partitë janë pjesë e Koalicionit PD-AN, referuar nenit 88, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, numri i votave të vlefshme takuese është 10.546 (dhjetë mijë e pesëqind e dyzetë e gjashtë), vlerë kjo e llogaritur duke mbledhur mesataren e votave për mandat për çdo kandidat të zgjedhur nga radhët e tyre. 622.187 (numri i votave të vlefshme të PD-AN)/ 59 (numri i mandateve)= 10.546 (vota/mandat).

Numri i votave të vlefshme në shkallë vendi $1.578.117$ (një milion e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë) dhe vlera 1% e tyre për llogaritjet: $1.578.117 * 0.01 = 15.781$ (pesëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e një) vota. Numri i votave të vlefshme takuese për partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje si pjesëtare të koalicionit PD-AN, të cilat nuk përfituan fonde para zgjedhjeve është 10.546 (dhjetë mijë e pesëqind e dyzetë e gjashtë) vota. Duke qenë se numri i votave të vlefshme për këto parti politike është më i vogël se pragu 1%, atëherë ato nuk përfitojnë kompensim financiar paszgjedhor.



PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “k” e “n”, dhe 2, 89 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe vendimit nr. 21 datë 13.07.2021, të Komisionit Rregullator, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021”,

V E N D O S:

1. Të mos shpërndaj kompensim financiar paszgjedhor për të gjitha subjektet zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisioni Ankimimeve dhe Sanksioneve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, brenda 3 (tre) ditëve nga data e shpalljes.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Iirjan CELIBASHI

